



# Fakulteti i Mjekesise ne mbeshtetje te studenteve

---

2016-2020




FAKULTETI I MJEKËSISË

Aktiviteti "Student per nje dite" u zhvillua ditën e hënë, datë 22.05.2017, me një leksion nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, Prof. Dr. Xheladin Draçini, në orën 8.00 në sallën Galileo Galilei.



# Vendimi Nr.1 date 05.06.2017 i Rektoratit "Per ngritjen e grupit te punes per hartimin e Rregullores se zgjedhjeve per keshillat studentore ne Universitetin e Mjekesise, Tirane".

[http://www.fakultetimjekesise.edu.al/images/export-2017-06-08-14-50-49.pdf?fbclid=IwAR0jQYWETpPheEGXiZEXVGgfm  
tIrmPSjTuNVxdzqyYpPH3u2b\\_bnl\\_xrRY](http://www.fakultetimjekesise.edu.al/images/export-2017-06-08-14-50-49.pdf?fbclid=IwAR0jQYWETpPheEGXiZEXVGgfmtIrmPSjTuNVxdzqyYpPH3u2b_bnl_xrRY)

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORATI

Nr. 1198, Prot. Tiranë, më 05.06/2017

**VENDIM**  
Nr. 1, datë 05.06/2017

*“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores së zgjedhjeve për këshillat studentorë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*

Bazuar në nenin 3, 40, 99 e vijues të ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 31 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pas diskutimit përkatës në mbledhjen e datës 05.05.2017, Rektorati,

**VENDOSI:**

- Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores së zgjedhjeve të këshillave studentorë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me përbërje si më poshtë:
  - zv/rektori;
  - 2 (dy) përfaqësuesit e studentëve, anëtarë të Senatit Akademik të UMT-së;
  - kryetari i KSUMT-së;
  - studentë përfaqësues nga fakultetet, përkatësisht:
    - 3 (tre) studentë nga Fakulteti i Mjekesise;
    - 3 (tre) studentë nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike;
    - 2 (dy) studentë nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare.
  - 1 (një) anëtar i Komisionit Institucional Zgjedhor të UMT-së.
- Përcaktimet dhe kriteret për procesin e aplikimit të studentëve në cilësinë e përfaqësuesve sipas pikës 1, germa d), janë:
  - Në Fakultetin e Mjekësisë kanë të drejtë të vetëkandidohen studentët që ndjekin studimet në programet:
    - Mjekësi e përgjithshme, viti IV ose V;
    - Farmaci, viti III ose IV;
    - Shëndet publik „Master i shkencave”, që janë në përfundim të vitit të parë akademik;
    - Specializime afatgjata në vite të ndërmjetme.

**KURSE PA PAGESE TE GJUHES FRENGE PER TE GJITHE  
STUDENTET DHE SPECIALIZANTET E FAKULTETIT TË  
MJEKËSISË.**

---





# KURSET E FRENGJISHTES

Ne kuader te bashkepunimit me Agjensine Universitare te Frankofonise (AUF) rifilluan kurset e gjuhes frenge.

Grupi fillestar: te henen, ora 11:00 salla 209 Godina e Paraklinikut

Grupi i avancuar: te marten ora 12:00 salla 209 Godina e Prakinikut

NJËSIA PEDAGOGJIKE DHE E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË

Njoftohen te gjithë studentet e vitit të parë, viti akademik 2017-2018 që të henen në orën 9.00 të sallës së leksioneve në godinën e lendeve paraklinike u organizua **Ceremonia e Bluzave të Bardha**.



# “Me zemer”

---

Njësia Pedagogjike dhe e Këshillimit të Karrierës organizoi eventin “Me zemer”. Mund të ndihmojmë më shumë nëse punojmë së bashku. U perzgjodhen dy qendra për aktivitetet vullnetare, Qendra e Fëmijës “Zyber Halluli” dhe Shtëpia e të Moshuarve “Ali Demi”, Tiranë. Aktiviteti u zhvillua në datën 20 Dhjetor 2017 dhe ka karakter social. Kontributi konsiston në ofrimin e disa kontrolleve mjekësore falas si dhe në organizime të tjera edukative në ndihmë të këtyre individëve. Janë të mirëpritur të gjithë ata që dëshirojnë të japin kontributin e tyre.






# “Me zemer”





# Rregullorja per Zgjedhjen e Keshillit Studentor ne UMT

<http://www.fakultetimjekesise.edu.al/arkiv/613-rregullorja-e-zgjedhjeve-per-keshillin-studentor-ne-umt.html?fbclid=IwAR3AS0IM8SiHXCRLmgCRCSowZYTmCOrA-eOvCnyDXdfoRggnKMxeiYxUv4>



Studentet Ekselente fitues per 4 **bursat e kursit te gjermanishtes** jane:

1. Arli Kristo Dega : Mjekesi e Pergjithshme
2. Hysni Bendo Dega : Mjekesi e Pergjithshme
3. Kristi Trako Dega : Mjekesi e Pergjithshme
4. Elena Axhara Dega : Farmaci

*Shenim : Ne 4 kuota te ofruara: 3 kuota jane per degen Mjekesi e Pergjithshme dhe 1 kuote per degen Farmaci. Fituesit jane renditur sipas mesatares se tyre, e cila nuk behet publike per te ruajtur konfidencialitetin e te dhenave te studenteve.*


# Foto me studentet ekselente gjate pergatitjes se klipit "Eja ne Teater"



# Ftese ne teater

---

Ne Teatrin Eksperimental (tek pedonalja) u ftuan te gjithe studentet dhe specializantet per te ndjekur shfaqjen " Darka e lamtumires" ne oren 20.00. Bileta falas.





# Aktiviteti "Student per 1 dite" u zhvillua në datën 15 Maj, në orën 09:00, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë

Po planifikoni të filloni studimet tuaja universitare në një nga programet e ofruara nga Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë? Dëshironi të keni mundësinë ta njihni nga afër Fakultetin tone?

Nëse dëshironi të kaloni një ditë në Fakultetin tone, të ndiqni një orë mësimore (leksion, seminar, laboratore apo praktika), të takoheni me stafin administrativ, të takoni profesorë të ndryshëm dhe të vizitoni ambientet e Fakultetit tonë, atëherë ju ftojme në programin tone "Student për një ditë".

## **CFARË PËRFSHIN PROGRAMI?**

- ✓ Do të kaloni një ditë i shoqëruar nga një student i Fakultetit tonë dhe do të keni mundësi të takoni studentë të tjerë për të marrë eksperiencat e tyre.
- ✓ Do t'ju jepet mundësia të ndiqni orë mësimore (leksion, seminar, laborator apo praktika).
- ✓ Do të keni mundësi të takoni një pjesë të stafit të administratës së Fakultetit.
- ✓ Do t'ju jepet mundësia të takoni profesorë të ndryshëm të Fakultetit.
- ✓ Mund të zhvilloni një vizitë në ambientet e Fakultetit

**PAS SUKSESIT VITIN E  
KALUAR, NJËSIA  
PEDAGOGJIKE DHE  
E KËSHILLIMIT TË  
KARRIERËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
UNIVERSITETI I  
MJEKËSISË, TIRANË**

**JU FTON:**

**"STUDENT PËR NJË DITË"**

**BËHU STUDENT PËR NJË  
DITË NË FAKULTETIN E  
MJEKËSISË, UNIVERSITETI I  
MJEKËSISË, TIRANË!**

## **KUSH MUND TË MARR PJESË?**

Studentë të ardhshëm të cilët tashmë kanë një ide të qartë rreth programit të studimeve universitare të cilin ata duan të zgjedhin.

Kriteret:

- ✓ Të jenë nxënës të vitit të fundit të shkollës së mesme
- ✓ Të përgatisin një letër motivimi prej 400 fjalësh, e cila do të bashkëngjitet në formularin e aplikimit.



## **SI MUND TË APLIKONI?**

Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen në linkun e mëposhtëm  
<https://goo.gl/forms/xs47FqwJ2mJxDgCv1>

Të përzgjedhurit do të njoftohen me email së bashku me gjithë detajet e programit. Për çdo informacion të mëtejshëm ju lutem kontaktoni në adresën tonë të emailit:  
[njesiapedagogjikedhekeshillimittekarrieres@fakultetimjekesise.edu.al](mailto:njesiapedagogjikedhekeshillimittekarrieres@fakultetimjekesise.edu.al)


## **KONTAKT**

Fakulteti i Mjekësisë  
Rruga e Dibrës, 371, 1005  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +355 4 236 27 10  
Email: [infofm@fakultetimjekesise.edu.al](mailto:infofm@fakultetimjekesise.edu.al)  
Web: [www.fakultetimjekesise.edu.al](http://www.fakultetimjekesise.edu.al)


# 18 Prill 2018

---

U ftuan studentet e Fakultetit te Mjekesise per te marre pjese ne Audicionet per aktor ne shafaqjen teatrale Maks Fish- Konti Ederland (Perkthyer nga Prof. Xheladin Dracini).



**Graf  
Öderland**  
Eine Moritat von Max Frisch

**DIALOG  
DER  
GENERATIONEN**  
  
6 - 99


**Produktion**  
Stadttheater Fürth


**Insenierung:**  
Nilufar K. Münzing

**Bühne:**  
Christiane Becker

**Kostüme:**  
Uta Gruber-Ballehr

mit  
Oliver Fobe  
Marie-Louise Gutteck  
Eva-Maria Kapser  
Rolf Kindermann  
Stefan Maaß  
Klaus Michalski  
Peter Pruchniewitz  
Markus Schmädicke  
Frank Watzke

  
Theaterverein  
Fürth

 **STADT THEATER FÜRTH**

Në sallat 401 dhe 403 të Godinës së lëndëve paraklinike u be gati për studentët që duan ta shfrytëzojnë këtë hapësirë për studim mbasdite.

\*E Hënë-E Premte (15:00-21:00)\*

KSFM



**KSFM Këshilli Studentor i Fakultetit të Mjekësisë**

February 26, 2019 · 🌐

Njoftojme studentet e FM se nga ora 16:00-21:00 jane ne dispozicion te studenteve si ambiente studimi, sallat ne katin e pare dhe ato ne katin e katert te godines se lendeve paraklinike. Falenderojme Fakultetin e Mjekesise per bashkepunimin dhe mbeshtetjen per realizimin e nje tjeter kerkese te artikuluar se fundmi dhe shume te domosdoshme ne kete periudhe provimesh.  
Suksese ne vazhdim!



# Ceremonia e bluzave te bardha viti akademik 2018-2019!





# Miratim kerkese studentore

Dekanati i Fakultetit te Mjekesise, njofton mbi miratimin e sezonit te Nentorit ne datat 15 dhe 16 Nentor 2018.

  
REPUBLIKA E SHqipërisë  
UNIVERSITETI I Mjekësisë, Tiranë  
FAKULTETI I Mjekësisë

Nr. 1748 Prot.

Tiranë më 15.10 2018

**L E N D A:** Njoftim mbi miratimin e sezonit të Nëntorit 2018

Njoftohen të gjithë studentët e Fakultetit të Mjekësisë të cilët nuk kanë arritur numrin e domosdoshëm të krediteve për të vazhduar vitin akademik 2018-2019, se Senati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me Vendimin Nr. 57 Dt. 11.10.2018 ka miratuar hapjen e një sezoni të posaçëm në muajin nëntor 2018. Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë në mbledhjen e tij të datës 25.10.2018 vendosi hyrjen në këtë sezon vetëm në dy provime në datat më poshtme:

**15 dhe 16 Nëntor 2018**

Regjistrimi do të bëhet në Sekretarinë Mësimore në datën 07.11.2018 ora 9.00-14.00

**DEKANI**  
Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI



Adresa: Rr. Dëshmorët, 371, Tirana, Albanisë; e-mail: info@mfakultetiinjekesise.edu.al  
website: www.fakultetiinjekesise.edu.al  
Tel. Fax: + 355 42362710

# Ftese ne Teater


---

U ftuan studentet e Fakultetit te Mjekesise per te marre pjese ne Audicionet per aktor ne shafaqjen teatrale Maks Frish- Konti Ederland (Perkthyer nga Prof. Xheladin Dracini).

Te interesuarit u paraqiten me karte ID tek godina e Lendeve Paraklinike kati I, klasa 104 ora 12.00 ditën e marte dhe te merkure ne datat 13-14 Nentor 2018.

DEKANATI

# 11 Dhjetor 2018 – Propozim per ofrimin falas te sherbimeve studentore ne FM



Ne sallen William A. Johnson u lancua **projekti "Rritja e kapaciteteve dhe e ndergjegjesimit per permiresimin e sherbimeve per personat qe jetojne me HIV/TB"**, projekt i Fakultetit te Mjekesise (UMT) i financuar nga Global Fund nen kujdesin e Ministrise se Shendetesise dhe te Mbrojtjes Sociale.

Ky projekt u prezantua tek studentët e Fakultetit të Mjekësisë, të trajnuar në Kroaci për të përditësuar dijet në fushën e sëmundjeve infektive.

Me pjesemarrje te vecante te :

Znj. Ogerta Manastirliu (Ministre e Shendetesise dhe e Mbrojtjes Sociale) dhe Prof. Dr. Arben Gjata (Rektor i Universitetit te Mjekesise, Tirane) dhe Prof. Dr. Xheladin Draçini (Dekan i Fakultetit te Mjekesise, Tirane).



# Një matje e thjeshtë shpëton jetë!

---

👉 Në vijim të fushatës globale të Majit Muajit të Matjes pranë 📍 Universitetit të Mjekësisë u bënë matjet e presionit arterial në bashkëpunim me OSHKSH, Tiranë [Shërbimi I Edukimit Dhe Promocionit Të Shëndetit, Tiranë](#) dhe [Fakulteti i Mjekësisë](#), si dhe me mbështetjen dhe punën e palodhur vullnetare të studentëve të Shëndetit Publik.

✦ Kjo fushatë synon fuqizimin e individëve nëpërmjet informimit dhe këshillimit për presion normal gjaku si dhe rritjen e aksesit ndaj depistimit të presionit arterial si mënyra potencialisht më efektive për të ulur efektet e dëmshme të hipertensionit në shëndet.

## Nje matje e thjeshte shpeton jete





Fakulteti i Mjekësisë me një histori 65 vjeçare tashmë, do të bashkonte të shkuarën dhe të ardhmen në Pallatin e Koncerteve në mbrëmjen e 21 shkurtit , në **Ceremoninë e Diplomimit të Studentëve për vitin akademik 2018**. Personalitete të fushës akademike, pedagogë, studentë e prindër, do të gjendeshin në të njëjtën sallë për të përmbyllur me sukses, historinë e çdo studenti të diplomuar.

---



Tek Teatri eksperimental ne pedonale hyrje  
e lire per studentet e Fakultetit te Mjekesise!

---





# Dita e Karrierës

---

Njësia Pedagogjike dhe Këshillimit të Karrierës- Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, në bashkëpunim me Agjensinë Universitare të Frankofonisë dhe me pjesëmarrjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale organizoi: Ditën e Karrierës.

Ky event u dha mundësinë studentëve, të diplomuarëve dhe specializantëve të Fakultetit të Mjekësisë, që të takoheshin dhe të informoheshin nga përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse, punëdhënës potencial si dhe ofrues të mundësive të studimit nga sektori publik dhe privat.

# Dita e Karrierës



# Tek Teatri eksperimental ne pedonale hyrje e lire per studentet e Fakultetit te Mjekesise!


---





# Tek Teatri eksperimental ne pedonale hyrje e lire per studentet e Fakultetit te Mjekesise!


---





# Tek Teatri eksperimental ne pedonale hyrje e lire per studentet e Fakultetit te Mjekesise!

---



Tek Teatri eksperimental ne pedonale hyrje  
e lire per studentet e Fakultetit te Mjekesise!

---



# Student per nje dite – 15 Maj 2019



# Tek teatri eksperimental ne pedonale per studentet e mjekesise hyrja falas!


---





# Tek teatri eksperimental ne pedonale. Hyrje e lire per studentet!

---





## "E dua Teatrin"

---

Ne daten 29 Mars ora 14.00 ne Godinen e Lendëve Paraklinike ne kat te pare u hapen audicionet per teater ne kuader te festivalit te universitare "E dua Teatrin". Vepra qe do te vihet ne skene eshte " Genjeshter per genjeshter". U ofruan studente qe kane te dhena per teater ose kane deshire te merren me te.

# U permbyll me sukses dhe transparence konkursi i specializimeve afatgjata ne mjekesi 2018-2019. Urime mjekëve te rinj dhe suksese te metejshme!

---





Në mbështetje të studentëve të vitit të fundit të Fakultetit të Mjekësisë (degët Mjekësi, Farmaci, Shëndet Publik) për të pasur një orientim mbi përpunimin statistikor, shkrimin dhe prezantimin e temës së diplomës, organizoi trajnimi didaktik me titull:

TEMA E DIPLOMËS 2019:

“PËRPUNIMI STATISTIKOR BAZË DHE SHKRIMI AKADEMIK” Date 11 Korrik,  
ora 10.30-12.30, Salla "William A. Johnson"

Trajnues:

Dr. Shk. Ilir Alimehmeti (Fakulteti i Mjekësisë)

Trajnimi drejtohej në mënyrë të veçantë studentëve të vitit të fundit të degëve Mjekësi, Farmaci dhe Shëndet Publik, por duke marrë parasysh ngjashmërinë e gjerë me shkrimin dhe prezantimin oral të kërkimeve shkencore, ishin të ftuar edhe studentët e interesuar në fushat e kërkimeve dhe publikimeve shkencore.


Pjesëmarrja në trajnim ishte e lirë dhe pa pagesë.





# Mbi mundesine e pranimi ne provimet e sezonit te studenteve qe perfitojne bursa me Erasmus+

1504  
1507/2019

  
REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORATI

Tiranë, më 15.07.2019

Nr. 2019 prot.

Kënda: Mbi mundësinë e pranimi në provimet e sezonit të studentëve që përfitojnë bursa me Erasmus+

**FAKULTETIT TË MJEKËSISË**  
Dekani, Prof. Xheladin DRAÇINI

**FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**  
Dekanes, Prof. Tatjana ÇINA

**FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE**  
Dekanes, Prof. As. Edit XHAJANKA

Të nderuar Dekanë,


Në kuadër të Erasmus +, studentë të Universitetit tonë kanë fituar bursa të BE nëpërmjet këtij programi dhe bazuar në marrëveshjen e studimit, pas përfundimit të periudhës së mobilitetit, studentëve iu njihen kreditet dhe vlerësimi përkatës për lëndët/modulet e përzgjedhura dhe të përfunduara (sipas marrëveshjes së studimit).

Janë konstatuar raste të studentëve të cilët kanë ndjekur një semestër pranë një universiteti të huaj, dhe nuk kanë frekuentuar disa lëndë të Universitetit tonë gjatë asaj periudhe, pasi nuk kanë qenë pjesë e kurikulës të universitetit pritës.

Në mënyrë që studentët që përfitojnë bursa me Erasmus+ të mos penalizohen për të dhënë provimet në lëndët të cilat nuk kanë frekuentuar, lutemi të shihet mundësia e pranimi të tyre në provimet e lëndëve/moduleve në sezonin e radhës, procedurë kjo e ndjekur dhe në Universitetet Shqiptare e të huaja.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**REKTORI**  
Prof. Arben GJATA



Adresa: Rruga e Dibrës , Nr. 371, 1005 – Tiranë. [www.umed.edu.al](http://www.umed.edu.al). [info@umed.edu.al](mailto:info@umed.edu.al)

Grupi i ekselencës i përbërë nga 14 studentë të degëve të ndryshme të UMT, nisen në Frankfurt të Gjermanisë trajnimin e specializuar për sëmundjet infektive.



Fakulteti i Mjekesise, UMT organizoi **Ceremonine e Bluzave te Bardha**, per studentet me te rinj te vitit akademik 2019-2020.

Date 14/10/2019

Ora 09:00

Salla e Leksioneve, Godina e Lendeve Paraklinike

---





# Kerkese studentore e miratuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
DEKANI

Nr. 1894/5 Prot.

Tiranë më 01.11 2019

**LËNDA:** Njoftim

Në bazë të shkresës së Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë Nr. 2697/1 Dt.28.10.2019 është miratuar hapja e një sezoni të veçantë në muajin Nëntor 2019 për të gjithë ata studentë të cilët nuk kanë arritur pragun minimal për kalimin në vitin akademik 2019-2020 dhe për studentët e viteve të fundit që janë në prag diplomimi. Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë në konsultim edhe me Këshillin studentor të FM vendosi që studentët të hynë në këtë sezon vetëm me dy provime.

Regjistrimi i provimeve do të bëhen në Sekretarinë Mësimore në datën 5 Nëntor 2019 ora 10.00-16.00

Provimet do të zhvillohen në datat 13 dhe 14 Nëntor 2019.


DEKANI  
Prof.Dr. Xheladin Draçini






# Thirrje per audicione

Studentet e Fakultetit te Mjekesise, ishin te ftuar per te marre pjese ne audicione per aktor/e ne shfaqjen teatrale Maks Fish - Konti Ederland (Perkthyer nga Prof.Dr Xheladin Dracini) e cila do te vendoset ne skene gjate muajit dhjetor ne Teatrin Kombetar. Te interesuarit te paraqiten tek godina Paraklinike ne katin e pare dite n e Premte me dt 8 Nentor ne oren 11.00.



**Graf  
Öderland**  
Eine Moritat von Max Frisch

DIALOG  
DER  
GENERATIONEN  
  
6 - 99


Produktion  
Stadttheater Fürth


Inszenierung:  
Nilufar K. Münzing

Bühne:  
Christiane Becker

Kostüme:  
Uta Gruber-Ballehr

mit  
Oliver Fobe  
Marie-Louise Gutteck  
Eva-Maria Kapser  
Rolf Kindermann  
Stefan Maaß  
Klaus Michalski  
Peter Pruchniewitz  
Markus Schmädicke  
Frank Watzke

  
Theaterverein  
Fürth

 STADT **THEATER** FÜRTH

# Biblioteka elektronike e Fakultetit te Mjekesise ne mbeshtetje te procesit mesimor

---





# Klubi Sportiv i Fakultetit te Mjekesise filloi kampionatin kombetar te minifutbollit te Federates Shqiptare te Sportit Universitar! Ndeshja e pare kunder UBT-se.



Ne kuadrin e Programit Erasmus+ zhvillohen leksionet e hapura nga dy perfaqesuese nga Universiteti i Craioves, Rumani: Prof. Suzana Danoiu, pedagoge e Fizpatologjise, dhe Znj. Laura Dinca, pergjegjese e zyres se Marredheneve me Jashte.

Programi  
(18.11.2019-22.11.2019)

---

E Marte (19.11.2019): Ora 0915-1115 “Pathophysiology of Obesity” (me paralelin II, viti III Mjekesi e Pergjithshme  
(salla e leksioneve, kati 4, Godina e lendeve paraklinike – godina e kuqe)

E Marte (19.11.2019): Ora 1230-1430 “Concept of disease” (me paralelin I, viti III Mjekesi e Pergjithshme  
(salla e leksioneve, kati 4, Godina e lendeve paraklinike – godina e kuqe)

E Merkture (20.11.2019): Ora 0915-1115 “Pathophysiology of inflammation” (me paralelin I, viti III Mjekesi e Pergjithshme  
(salla e leksioneve, kati 4, Godina e lendeve paraklinike – godina e kuqe)

E Merkture (20.11.2019): Ora 1245-1445 “Pathophysiology of fever” (me paralelin II, viti III Mjekesi e Pergjithshme  
(salla e leksioneve, kati 4, Godina e lendeve paraklinike – godina e kuqe)

Jane te ftuar dhe specializantet te ndjekin keto leksione.



Drama “Konti Edërland” nga Max Frisch rreth fundit të viteve 50 flet për një dramë social politike . Kjo shfaqje është ngritur mbi legjenden e fëmijëve “ Konti Ederland “ . Historia ka të bëjë me një prokuror të shtetit të quajtur Martin i cili mërzitet me ekzistencën e tij të klases së mesme , dhe duke u frymëzuar nga legjenda , ai vendos kërkimin e lirise se tij duke përdorur një sepate për këdo që i pret rrugën e tij . Ai përfundon si drejtues i një lëvizje revolucionare lirë, dhe konstaton se fuqia dhe përgjegjësia që pozicioni i tij i ri imponon atij , e lë pa liri më shumë sesa ai kishte më parë .

Premiera Shfaqjes me datë 16 dhe 17 Dhjetor në sallën e Teatrit Kombëtar në Pedonale ora 19.00!  
Hyrja do të jetë e lirë për të dyja shfaqjet.

Shfaqje e Studentëve të Fakultetit të Mjekësisë



# KONTI EDERLAND

MAX FRISCH

Drejtor i Shfaqjes Eni Picalli Shqipëroi Xheladin Dracini  
Regjia Stela Doka Koreografe Pamela Rexhepi  
As.regjisor Franci Doka Skenografia Ermela Marku

Interpretojnë

Eduart Hoxha, Marsela Hoxha, Roberta Elezi, Domeniko Hysenji, Orsuid Morisani,  
Marslida Agalliu, Fabjola Kamberi, Rogerta Marku, Jurgen Lika, Driona Osmani,  
Gebin Nexha, Elvis Laçeja, Tetem Velza, Admir Muja, Franci Doka, Fatjon Biba,  
Fatjon Dokle, Migen Ejup, Anxhela Shabanaj, Nada Hoxha, Rexhjana Hoxha, Elvan Muho



# U-LIBRARY

---

## BIBLIOTEKA ONLINE

Lista e paketave qe perfshihen U-LIBRARY jane:

- 1) Academic Search Complete : databaza kryesore e revistave/periodikeve/librave/etj te dedikuar vetem per arsimin e larte dhe kerkimin
- 2) Business Source Complete
- 3) Regional Business News Plus
- 4) Newspaper Source Plus
- 5) MasterFILE Complete
- 6) Health Source: Academic & Nursing Edition
- 7) Health Source: Consumer Edition
- 8) ERIC
- 9) MEDLINE
- 10) Rosetta Stone Library Solution Plus
- 11) eBook Academic Collection
- 12) EBSCO Discovery Service (EDS) (without OPAC)

U-library eshte publikuar ne website zyrtar [www.fakultetimjekesise.edu.al](http://www.fakultetimjekesise.edu.al) nen emertimin BIBLIOTEKA ONLINE sic tregohet ne imazhin bashkengjitur ose mund te klikoni direkt ne linkun: [http://widgets.ebscohost.com/.../n.../searchbox/ns283996\\_al.html](http://widgets.ebscohost.com/.../n.../searchbox/ns283996_al.html)

# Projekti GRADUA

---



Avancimi i Diplomave dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Universitare në Shqipëri (GRADUA)

Ftohen studentet e vitit të gjashtë Mjekesi e Përgjithshme, studentet e vitit të pestë Farmaci dhe të gjithë të diplomuarit së fundmi të regjistruar në platformën e projektit Gradua në linkun : <https://gradua.rash.al/stud/registration/Default.aspx...>

Projekti GRADUA, i cili financohet nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, do të mbështesë universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë-ofertë të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve, përmes: mbledhjes së të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe bizneseve; lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës.

Implementimi i këtij projekti do të ndihmojë në organizimin e informacionit, duke lejuar kështu edhe monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të sistemit të trajnimit dhe të tregut të punës, lidhjes së tyre dhe parashikimin e aftësive të nevojshme në të ardhmen, për t'ju përshtatur më së miri këtij tregu.

Projekti GRADUA do të mbështesë universitetet shqiptare për krijimin e modelit të integruar kërkesë-ofertë, përmes:

mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi performancën dhe universitetin e të diplomuarve, duke gjeneruar dokumentim të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për vlerësimin e sistemit të Arsimit të Lartë në mbështetje të proceseve reformuese në vijimësi;

lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe botës së biznesit (do të zhvillohen shërbimet IT online që do të vendosen në dispozicion si të të diplomuarve, ashtu edhe të stafit universitar dhe kompanive të biznesit);

lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës.

# Projekti GRADUA

---





Fakulteti i Mjekësisë është pjesëmarrës në aktivitetet që FSHSU organizon si: minifutboll, volejboll dhe basketboll, nën drejtimin e profesorit [Ilir Alimehmeti](#), që nxiti dëshirën e këtyre studentëve në angazhimin maksimal ku, pa mbështetjen e tij pjesëmarrja e këtij fakultetit do të ishte e pamundur. 🙌🙌🙌  
Faleminderit Rini Studentore për energjinë dhe vlerat që mbartni duke u kujdesur për mirëqenien tuaj psiko- fizike! 🤝





# Inagurimi i laboratorit te biosimulimit per studentet e Mjekesise

Projekt tashme i realizuar me sukses dhe i gatshem per t'u implementuar ne mesimdhenie.Laboratori ndodhet prane godines se Telemedicines



Ndihem shume i lumtur dhe krenar te uroj te gjithë pedagoget, stafin administrativ, specializantet, studentet dhe gjithë rrjetin formues te Fakultetit te Mjekesise per akreditimin me vleresim maksimal te programeve te studimit Mjekesi e Pergjithshme dhe Farmaci! Ky vleresim i larte, perben nje moment historik madhor ne rrugetimin e fakultetit dhe nje plotesim te natyrshem pas akreditimit institucional te Universitetit te Mjekesise, fale punes se perkushtuar gjate kater viteve te fundit te stafit akademik dhe studenteve tane te mrekullueshem 😊 - Prof. Xheladin DRACINI





# FOTOGALERI





# FOTOGALERI





# FOTOGALERI






# FOTOGALERI





# FOTOGALERI





# FOTOGALERI



# FOTOGALERI

